



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1158/ Prot.

Tiranë, më 19.7.2024

2

VENDIM

Nr. 23, datë 15.07 2024

“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në disa programe studimi të ciklit të parë, dhe në programin e ciklit të tretë të studimeve, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2024-2025”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1 dhe pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, gërma a, b dhe c, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5, gërma “d”, dhe neni 31, gërma “q”; në Urdhrat e hapjes të Minsitrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UT-së, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Tiranës, në 3 (tre) programe studimi të ciklit të parë dhe të 1 (një) programi të ciklit të tretë të studimeve për vitin akademik 2024-2025.
2. Numri i kuotave të pranimit për programet e studimit është si më poshtë vijon:
 - 2.1 Numri i kuotave të pranimit për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Frënge dhe Gjuhë e Shenjave Shqipe”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja është **31**.
 - 2.2 Numri i kuotave të pranimit për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Kimi Farmaceutike”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është **60**.
 - 2.3 Numri i kuotave të pranimit për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizikë dhe Shkenca Kompjuterike”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është **60**.
 - 2.4 Numri i kuotave të pranimit për programin e përbashkët të studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv” në “Siguri Informacioni dhe Informacion Strategjik”, në Fakultetin e Ekonomisë është **30**.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

